

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri nr. 10209, datë 23.12.2009 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “PER PROCEDURAT TATIMORE” ju informojmë se janë kryer ndryshimet si më poshtë:

- **NENI 16 - STRUKTURA E ADMINISTRATES TATIMORE QËNDRORE**

Nenit 16 i shtohet pika e), e cila parashikon shtimin e funksionit të investigimit të brendshëm antikorrupsion si një nga funksionet e kryera nga administrata tatimore qëndrore.

- **NENI 40 – REGJISTRIMI I PERSONAVE QË USHTROJNË VEPRIMTARI TREGTARE DHE JOTREGTARE**

Këtij neni i ndryshohet emërtimi, duke u quajtur “ Regjistimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare”.

Sipas ndryshimeve të parashikuara në pikën 4, personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbime ambulante si dhe kryefamiljarët që punësojnë persona si punëtorë shtëpie, duhet të drejtohen organeve tatimore për procedurat e regjistrimit për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore ose për çregjistrimin e tyre. Këto procedura do të përcaktohen në udhëzimin që Ministri i Financave do të nxjerrë pr shtjellimin e ligjit në fjale.

- **NENI 65 – DORËZIMI DEKLARATËS TATIMORE**

Këtij neni i shtohet pika 6, sipas të cilës Këshillit të Ministrave i jepet e drejta të përcaktojë afatet kohore për dorëzimin e deklaratave tatimore e të dokumentave të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike.

Për kete qëllim, Këshilli i Ministrave ka aprovuar edhe një vendim në datën 03.02.2010, në të cilin përcaktohen në menyre të qartë cilat jane deklaratat dhe dokumentat e tjera tatimore të cilat do të duhet të paraqiten pranë organeve tatimore përkatëse brenda afateve të parashikura në këtë vendim.

- **NENI 68 – VLERËSIMI TATIMOR**

Pika 8 e këtij neni modifikohet, duke përcaktuar se në rastet kur administrata tatimore konstaton se shumata e detyrimit tatimor, e detyrueshme për tu paguar, sipas deklaratës tatimore, ka një vlerë deri në 100 (njëqind) lekë, ky detyrim do të konsiderohet si detyrim me vlerë zero; në rastet kur konstatohen detyrime me të tilla vlera, administrata tatimore nuk do të kryejë vlerësim tatimor.

- **NENI 105 – STRUKTURA DHE FUNKSIONET E NJËSIVE TË HETIMIT TATIMOR**

Këtij neni i shtohet neni 105/1, i quajtur “Struktura dhe funksionet e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) dhe të njësive të hetimit tatimor”, i cili përcakton cilësitë dhe qëllimet parësore të Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm, si dhe atributet që iu jepen punonjësve të saj.

• **NENI 111 – DËNIMET ADMINISTRATIVE**

Këtij neni i shtohet pika 5, e cila përcakton se vlera e gjobave të vendosura për shkelje administrative (në lidhje me një detyrim tatimor), nuk mund të jetë më e madhe se 100 për qind e detyrimit tatimor në fjalë.

• **NENI 114 – MOSPAGIMI NË AFAT I DETYRIMIT TATIMOR APO I KONTRIBUTIT**

Pika 1 e këtij neni modifikohet, duke përcaktuar se masa e gjobës së aplikuar në rastet e mospagimit në kohë të detyrimit tatimor apo të kontributit duhet të jetë e barabartë me 5 për qind të vlerës së detyrimit të papaguar; gjithashtu, kjo pikë parashikon se vlera e gjobës nuk mund të jetë në asnjë rast më e madhe se 25 për qind e detyrimit të papaguar, por hiqet vlera minimale e gjobës prej 10 000 lekësh, e cila parashikohej para ndryshimit të kësaj pike.

Neni 114 i shtohet edhe pika 3, e cila parashikon se gjoba e parashikuar në piken 1 aplikohet edhe në rastet kur tatimpaguesi ndryshon deklaratën fillestare, në bazë të kërkesave të parashikuara në nenin 67 të Procedurave Tatimore.

• **NENI 115 – PLOTËSIMI I PASAKTË I DEKLARATËS TATIMORE DHE KËRKESA E PASAKTË PËR RIMBURSIM**

Pika 1 e këtij neni modifikohet, duke përcaktuar se masa e gjobës së aplikuar në rastet e dorëzimit të një deklaratë tatimore të pasaktë apo të një kërkesë të pasaktë për rimbursim duhet të jetë e barabartë me 5 për qind të vlerës së detyrimit të papaguar apo rimbursimit të kërkuar më tepër; gjithashtu, kjo pikë parashikon se vlera e gjobës nuk mund të jetë në asnjë rast më e madhe se 25 për qind e detyrimit të papaguar, por hiqet vlera minimale e gjobës prej 10 000 lekësh, e cila parashikohej para ndryshimit të kësaj pike.

• **NENI 119 – MOSDEKLARIMI I TË PUNËSUARVE**

Ky nen modifikohet plotësisht, duke i dhënë të drejtën organeve tatimore që të kryejnë verifikime në vendndodhjen e biznesit të tatimpaguesit dhe të aplikojnë gjoba në rast se tatimpaguesi nuk ka deklaruar pranë organeve tatimore çdo të punësuar rishtazi, të paktën 24 orë përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagesën e shumës së kontributeve të papaguara.

Gjoba në fjalë do të ketë vlerën prej 50 000 (pesedhjetë mijë) lekësh në rastin kur subjekti është biznes i vogël dhe 100 000 (njëqind mijë) lekësh në rastin kur subjekti është biznes i madh me TVSH, për çdo rast mosdeklarimi.

• **NENI 122 – KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE NË PËRDORIMIN E**

**PAISJEVE FISKALE, PËR LËSHIMIN E KUPONAVE  
FISKALË E TË BILETAVE.**

Ky nen modifikohet në mënyrë radikale, duke parashikuar dënimin me gjobat specifike për çdo lloj shkeljeje të përmendur në mënyrë të detajuar, si dhe duke arritur në masa ekstreme (mbyllje e plotë e veprimtarisë ) në rastet e konstatimit nga organet tatimore të përsëritjes sistematike të këtyre shkeljeve nga ana e tatimpaguesit.

Gjithashtu, pika 2 e këtij neni parashikon se kompetencat e konstatimit, shqyrtimit dhe dhënies së dënimit perkatës të parashikuar në këtë nen, i takojnë organit tatimor të juridiksionit në të cilin tatimpaguesi ushtron veprimtarinë ose kryen shkeljet.

• **NENI 123 – DËNIMET PËR SHOQËRITË E AUTORIZUARA DHE TË PAAUTORIZUARA**

Këtij neni i ndryshohet emërtimi, duke u quajtur “Dënimet për shoqëritë e autorizuara dhe të paaautorizuara”.

Gjithashtu, këtij neni i shtohet pika 2, e cila parashikon një gjobë prej 1 000 000 (një milion) lekësh për shoqëritë që tregtojnë ose mirëmbajnë pajisje fiskale të palicënsuara nga Ministri i Financave tek subjektet e tjera tatimpaguese, dhe një gjobë prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh për shoqëritë që blejnë dhe përdorin pajisje të tilla si dhe sekuestrim të pajisjes fiskale.

✓ **NENI 127 – PENGIMI I KONTROLLIT OSE I HETIMIT TATIMOR**

Këtij neni i shtohet pika 3, e cila i jep organeve tatimore të drejtën e sekuestrimit të dokumentacionit, pajisjeve kompjuterike dhe fiskale si dhe mjeteve të tjera të mbajtjes së dokumentacionit të tatimpaguesit në ambjentet e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit, në rastin kur ato disponojnë të dhëna të besueshme se tatimpaguesi fsheh informacione mbi gjendjen e tij ekonomike-financiare.

Ky ligj është shpallur me dekretin nr 6385, datë 13.01.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, dhe **hyn në fuqi në datën 04.02.2010.**

Juliana Muço

KONSULENTE FISKALE E FINANCIARE

